

VENDIM
Nr.121, datë 9.10.2008

**PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENPOWER ALBANIA” SHPK PËR KREYRJEN E AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pikat 1, germa “d”, dhe 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pika 2, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pikat 1 germa “a”, dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.10.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi:

1. Mosparaqitjen e plotë të dokumentacionit të kërkuar sipas rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k. më datë 24.9.2008 për licencimin për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike në lidhje me:

- Paraqitjen e strukturës së ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca) (neni 9, pika 2, germa “e”, nuk është plotësuar. Janë paraqitur vetëm disa CV të personelit të shoqërisë.

- Kërkesa për dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.).

- (Neni 9, pika 3, germa “c” rezulton jo e plotësuar në përputhje me rregulloren, pasi referencat bankare të paraqitura mbajnë datën 20.11.2007 dhe janë lëshuar për t’u paraqitur në aplikimin e shoqërisë për licencë në aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” neni 8, pika 3, për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta